



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2023/0880**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje Vedat Poterqoi - Kryetar, Vjosa Gradinaj Mexhuanj - Anëtare dhe Isa Hasani - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “2A Group” SH.P.K. ushtruar kundër Vendimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i QKMF-se ne Drenas” me numër prokurimi ”206-23-6378-5-1-2”, iniciuar nga “Ministria e Shëndetësisë” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) me 19.01.2024, mori:

### **Vendim**

1. **Aprovohet** si e bazuar, ankesa e OE “2A Group” SH.P.K. e datës 08.11.2023 (Protokolli Nr.880/2023), Anulohet vendimi i datës 23.10.2023, Ministrisë së Shëndetësisë, nga e autoritetit kontraktues, kurse aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i QKMF ne Drenas” me numër prokurimi 206-23-6378-5-1-2, kthehet në ri-vlerësim.

2. Bëhet kthimi i mjeteve të deponuara në emrin e tarifës ankimore, në emër dhe për llogari të ankuesit, i cili duhet të parashtrorj kërkesë për kthimin e mjeteve, në afat prej 60/gjashtëdhjetë ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi, në të kundërtën mjetet konfiskohen dhe kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

### **Arsyetim**

*- Faktet dhe rrethanat procedurale -*

Me 23.06.2023 Ministria e Shëndetësisë, duke vepruar në cilësinë e autoritetit kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë (B05) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i QKMF-se ne Drenas” evidentuar me numër prokurimi ”206-23-6378-5-1-2” për të cilin është zhvilluar procedurë e hapur, lloji i kontratës pune, vlera e parashikuar 2.976,487,83€. Ndërsa më dt. 23.10.2023, AK ka publikuar edhe listën e OE të cilën janë kualifikuar për në fazën tjetër.

Me 25.10.2023, OE “2A Group”, SH.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të cituar si më sipër, e cila është refuzuar si e pa bazuar me vendimin e AK të datës 01.11.2023.

Me 08.11.2023, OE “2A Group” ka parashtruar ankesë kundër vendimit të cituar si më sipër të autoritetit kontraktues, në Organin Shqyrtues të Prokurimit [Protokolli 880/2023]

*Në fazën e shqyrtimit paraprak,*

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e parapara me nenin 111 dhe është parashtruar brenda afatit ligjor në harmoni me nenin 109 paragrafi 1 të LPP, pas zbatimit të procedurës paraprake sikurse kërkohet në kuptim të nenit 108/A të LPP. Meqë parashtruesi është palë e interesuar sikurse përkufizohet me paragrafin 1.26 të nenit 4, lidhur me paragrafin të nenit 109 dhe paragrafin 1 dhe 1.5 të nenit 111, kurse ankesa i përmban elementet e cituara si më sipër, do të thotë se e njëjta bije nën kompetencat e këtij Organi në kuptim të nenit 98 dhe 105 të LPP.

Bazuar në veprimet si më sipër, OSHP ka caktuar Panelin Shqyrtues sipas nenit 111, paragrafi 5 (ii) të LPP dhe ka angazhuar ekspertin shqyrtues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 (i) të LPP, me detyrë që i njëjti ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, në kuptim të nenit 113 dhe 114 të LPP lidhur me nenin 17 dhe 19 të Rregullores për punën e OSHP. Me 20.11.2023 Eksperti Teknik ka dorëzuar Raportin Nr. 2023/880, me rekomandimet si në vijim:

ankesa të refuzohet si e pa bazuar.

të mbetet në fuqi vendimi i atakuar i autoritetit kontraktues;

Raporti i ekspertizës përmban elementet qenësore sikurse kërkohet me nenin 113, paragrafi 3 të LPP dhe i njëjti është pranuar nga palët, sikurse kërkohet me nenin 115 të LPP lidhur me nenin 20 të Rregullores së cituar. Në këtë rast evidentohet se ankuesi nuk është pajtuar me raportin dhe/ose rekomandimet e cituara, kurse, AK është deklaruar se pajtohet. Po ashtu konstatohet se palët janë në dijeni lidhur me shkresat e kësaj lënde sikurse kërkohet me paragrafin 2, të nenit 20 të Rregullores së cituar andaj Paneli konsideron se ka kushte për të vendosur në mënyrë meritore.

*- Administrimi dhe vlerësimi i provave –*

Paneli konstatoi paraprakisht senuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me nenin 4, paragrafi 1.75 të LPP, prandaj mori në shqyrtim të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të caktohet seanca publike me palë, duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtruesit e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor lidhur me rastin, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP. Paneli në këtë rast analizoi të gjitha pohimet ankimore, aktet dhe veprimet e palëve, ekspertizën e cituar të cilat (në përmbledhje) i administroi dhe analizoi si në vijim:

Ankuesi ka atakuar vendimin e cituar si më sipër të autoritetit kontraktues, për eliminimin e tij në këtë fazë (faza e parë) të këtij aktiviteti të prokurimit nga AK, me arsyetimin se, cituar: “Deklarata nën betimtë 2A Group SH.P.K. është nënshkruar nga pronari Valon Ademi, po ashtu dhe deklarata nën betim e 2T SH.P.K është paraqitur Valon Ademi si administrator, mirëpo dallon nënshkrimi në mes dy deklaratave. Në certifikatën e biznesit Pronar në 2A është Valon Ademi dhe personi i autorizuar në 2T është Valon Ademi me të njëjtin numër personal”. Përderisa sipas Raportit të ekspertit shpjegohet dhe konstatohet se, AK në vendimin e tij lidhur me kërkesën për rishqyrtim të datës 01.11.23, ka theksuar, cituar: “Po në këtë fazë, ZPP pas shqyrtimit të dokumentacioneve pajtohet se ju e plotëson kriterin e punëve të kryera në vlerë 3 milion në tri vite e fundit siç është kërkuar në NJK dhe në DT”.

Ndërsa AK në vendimin e kërkesës për rishqyrtim të datës 01.11.23, potencohet se “Në ofertën e juaj ju nuk e keni prezantuar autorizimin e 2A Group, për znj. Hamdije Idrizi-Krasniqi, të cilën e dëshmoni tani në kërkesën tuaj për rishqyrtim. Por edhe sikur ta kishit prezantuar këtë autorizim në deklaratën nën betim të kompanisë 2A Group, nuk është dashur të shënohet emri Valon Ademi e të nënshkruaj znj. Hamdije Idrizi-Krasniqi, në emër të tij por tek emri është dashur të shënohet Hamdije Idrizi –Krasniqi e të nënshkruaj e njëjta në emër të vet si e autorizuar”. Në vendimin e cituar si më sipër, AK është referuar një opinionin të Komisionit Rrregullativ të Prokurimit Publik, sipas të cilit çështja për të autorizuar një person që të nënshkruaj Deklaratën nën Betim dhe ose dokumentet tjera të Dosjes së Tenderit në emër të përfaqësuesit të Operatorit Ekonomik, nuk rregullohet me dispozita të LPP dhe legjislacionit dytësor të nxjerrë nga KRPP por me ligje tjera në fuqi. *Megjithatë, opinionin e KRPP-së është si në vijim:*

Për derisa në Formularët Standard të Dosjes së Tenderit, përfshirë “Deklaratën nën Betim” dhe dokumentet tjera (Kërkesa për qasje në dokumente zyrtare, Kërkesa për Sqarim, Formulari i Tenderit etj.) në të cilat kërkohen të dhënat mbi identifikimin e përfaqësuesit të Operatorit Ekonomik (Emri dhe Mbiemri, pozita, nënshkrimi, data dhe vula), pra kërkohet të plotësohen dhe të nënshkruhen nga përfaqësuesi i Operatorit Ekonomik, rrjedhimisht të njëjtat dokumente nuk mund të nënshkruhen nga një person tjetër jo kompetent apo që nuk ka autorizim për të nënshkruar dokumentet në fjalë. Në pamundësi të nënshkrimit të dokumenteve në fjalë nga përfaqësuesi i operatorit Ekonomik, i njëjti mund të veprojë sipas rregullave mbi autorizimin të përcaktuara me ligjet përkatëse në fuqi në Republikën e Kosovës.

Gjatë administrimit me shkresat e kësaj lënde, Paneli vëren se krahas këtyre pohimeve ankimore, në raportin e ekspertizës, janë përfshirë dhe analizuar: Njoftimi mbi vendimin e AK-së të datës 24.10.23; vendimi mbi kërkesën për rishqyrtim të datës 01.11.23; Deklarata nën betim e OE2T SH.P; Deklarata nën betim të OE 2A Group SH.P.K; Autorizimi i bashkangjitur në kërkesën për rishqyrtim dhe Ankesën e parashtruar në OSHP (kopja e aktit noterial me LRP. Nr. 10253/2000).

Në vështrim të dokumenteve të cituara si më sipër, ekspertja ka shpjeguar se përmes aktit noterial LRP. Nr.10253/2020, ankuesi e ka autorizuar znj. Hamide Idrizi –Krasniqi që ta përfaqësoj pranë të gjitha institucioneve dhe organeve në Republikën e Kosovës, para organeve lokale dhe qendrore të gjitha organeve administrative, ministri, organeve gjyqësore, policore

qendrës për punë sociale, ATK-së dhe pranë çdo organi tjetër që paraqitet nevoja për rregullimin e të gjitha dokumenteve të nevojshme, etj. Duke konstatuar po ashtu se në vështrim të datave dhe dokumenteve të përshkruara si më sipër, rezulton se ky autorizim është para datës së njoftimit për kontratë dhe para afatit për dorëzimin e tenderëve, përkatësisht me datë 30.11.2020.

Megjithatë, sipas vendimit të cituar si më sipër të AK, çështje kontestuese është se në dy deklaratat nën betim të dy pjesëmarrësve (operatorëve ekonomik) të konzorciumit, është emri Valon Ademi, kurse janë dy nënshkrime të ndryshme. Pra, në njërin deklaratë nën betim ka nënshkruar Valon Ademi, kurse në deklaratën nën betim të anëtarit tjetër të konzorciumit ka nënshkruar znj. Hamdije Idrizi Krasniqi edhe pse figuron emri dhe mbiemri Valon Ademi. Andaj, ekspertja shqyrtuese vlerëson se përderisa në deklaratën nën betim është emri dhe mbiemri i personit Valon Ademi kurse nënshkruan znj. Hamdije Idrizi Krasniqi në emër të tij, atëherë kjo deklaratë nën betim nuk duhet të pranohet për shkak se deklarata nën betim ka për qëllim që personi i cili vendos emrin dhe mbiemrin e vet, të deklaroj se është i përshtatshëm konform nenit 65 të LPP-së, si dhe pranon mundësinë e sanksioneve penale dhe civile, duke nënshkruar me dorën e tij për pranimin e përgjegjësive të cilat burojnë nga kjo deklaratë nën betim. Për më tepër, të çështja e deklarimit të marrjes së përgjegjësisë penale, duhet sqaruar se përgjegjësia penale është përgjegjësi individuale dhe asnjë person nuk mund të marr përgjegjësinë e tjetrit, ku në këtë kuptim duhet të nënshkruar personi i njëjtë që i figuron emri dhe mbiemri. Në rastin konkret, sikur të vendosej emri dhe mbiemri i znj. Hamdije Idrizi Krasniqi që ka nënshkruar deklaratën nën betim, atëherë do të vlente autorizimi i dhënë sipas aktit noterial, por jo të figuron emër dhe mbiemër tjetër ndërsa nënshkrim i një personi krejt tjetër. Andaj, ekspertja shqyrtuese konsideron se pretendimi i OE ankues është i pa bazuar.

*- Gjetjet e Panelit Shqyrtues -*

Pas administrimit dhe vlerësimit të shkresave të kësaj lënde dhe provave të bashkëngjitura, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, Paneli shqyrtues konsideron se ankesa duhet aprovuar si e bazuar dhe të anulohet Vendimi i atakuar i autoritetit kontraktues meqë AK nuk ka trajtuar në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese OE pjesëmarrës, duke u bazuar në dokumentacionin e prezantuar dhe dëshmitë dëshmuese për shkaqet dhe arsyet si në vijim:

1. Ankuesi posedon autorizimin e personit i cili ka nënshkruar në emrin e tij (i njëjti) është më i hershëm se data e ofertimit dhe konform interpretimit të KRPP nr. 14 të datës 24.10.2023, kurse të gjitha dokumentet (përfshirë dhe ato për themelimin e grupit dhe jo vetëm deklarata nën betim) janë të nënshkruara nga i autorizuari, nga po nga kjo cilësi është dhe person përgjegjës i caktuar nga lideri i konzorciumit. Kjo është dhe një nga arsyet se AK këtë (emri i vendosur i pronarit, e jo i të autorizuarit i cili ka vendosur nënshkrimin) mund ta konsideroj si devijim të vogël në kuptim të paragrafit 4, të nenit 59 të LPP, sipas të cilit është parashikuar dhe/ose rregulluar fare qartë se, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të

vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Paneli konsideron se mandati i të autorizuarit në rastin konkret nuk mund të mohohet si i tillë dhe i njëjti (për nevojat e AK) mund të nënshtrohet informacioneve apo shpjegimeve shtesë, natyrisht pa e ndryshuar kushtin material apo kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit, sepse në kuptim të paragrafit 3, të nenit 72 [Dokumentacioni dhe informacioni shtesë], shpjegohet dhe/ose parashihet fare qartë se, cituar: “sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive”, dhe nëse konsideron se është e nevojshme ti përdor autorizimet në kuptim të nenit 52.7 të LPP.

Në kontekstin e shpjegimeve si më sipër, Paneli vëren se të gjitha dokumentet e tenderit pa nevojë për ti cituar ato karakterizohen nga të njëjtat nënshkrime gjë që ky përbën një fakt objektiv i cili në vrojtim të dokumenteve nuk mund të mohohet as nga ky Panel. Krahas kësaj duhet megjithatë shtuar faktin se e autorizuar është caktuar edhe menaxhere e këtij projekti dhe se pozita e saj në këtë rast është specifikuar si e tillë nga kuadri i vëllimit të të drejtave të cilat po ky autorizim i përmban dhe si rrjedhojë e shpjegimeve si më sipër roli dhe pozita e saj nuk mund të konsiderohet ndryshme me përjashtim të “devijimit të vogël”.

2. Duke ju referuar interpretimit të KRPP, Paneli shpjegon se çështja e autorizimit nuk rregullohet me dispozita të LPP por me ligje tjera në fuqi dhe konsideron se autorizimi nuk karakterizohet me ndonjë të metë, i/e cila do ti mohonte efektet juridike të tij dhe i njëjti është dhënë nga titullari i një të drejtë, sipas të cilit i autorizuari ka të drejtë zbatojë një aktivitet, projekt apo të kryej veprime të caktuar, në pajtim me kushtet e përshkruara sikurse parashihet mes tjerash dhe me nenin 17 të Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative. Në të vërtetë nuk mund të kontestohen veprimet e përfaqësimit të një subjekti (juridik apo fizik) nga palë të treta nëse ato janë të pranueshme nga titullari i asaj të drejte, përfshirë dhe deklaratën në betim. Në të vërtetë, përmbajtja e autorizimit, respektivisht elementet qenësore, përfshirë sidomos vëllimin dhe efektet juridike të tij, rregullohen në mënyrë specifike me Ligjin për marrëdhëniet e detyrimeve [LMD], me të cilin Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nuk përmban absolutisht asnjë normë kolizive. Sipas LMD autorizimi i referohet ekskluzivisht vullnetit të titullarit, me ç’ rast sipas nenit 72, duke e shpjeguar fare qartë se autorizimi për përfaqësim bazohet në ligj, në aktin e përgjithshëm të personit juridik, në aktin e organit kompetent ose në vullnetit e të përfaqësuarit. Prandaj, raporti i ekspertizës përmban një Pasqyrim real dhe objektiv për të gjitha aktet dhe veprimet e palëve, mirëpo në kontekstin efekteve juridike të tij, Paneli në këtë rast ndan mendimin e tij/saj në raport me pikëpamjet e ekspertit shqyrtues. Në kuptim të legjislationit, raporti i një eksperti përfshihet në procesin e administrimit krahas të gjitha shkresave tjera dhe të njëjtit i njihet efekti provues në relacion me vlerësimin e të gjithave së bashku. Në fakt, në kontekstin e dispozitave 113 dhe 114 të LPP, në raport me kompetencat e parapara me nenin 98, 99 dhe 105 të LPP, raporti i një eksperti ka karakter deklarativ lidhur me

gjetjet dhe hulumtimet e realizuara në një fazë paraprake të aktivitetit të prokurimit dhe i njëjti nuk mbisundon mbi pavarësinë institucionale të organit dhe kompetencat e tij/saj vendimmarrëse.

*-Përfundim –*

Paneli konsideron se vendimi i atakuar i autoritetit kontraktues, nga aspektet e cituara si më sipër karakterizohet me shkeljet e shpjeguara dhe se i njëjti duhet anuluar për shkaqet e theksuara si më sipër. Paneli konsideron se me rastin e marrjes së këtij vendimi janë administruar në masë të mjaftueshme të gjitha provave në dispozicion të kësaj lënde dhe se në marrjen e vendimeve gjithnjë ka parasysh dhe nenin 1 të LPP-së, sipas të cilit qëllimi i këtij ligji është të siguroj transparencën përgjegjësinë dhe integritetin e prokurimit publik.

Andaj nga të lartcekurat, e duke vepruar në harmoni me kompetencat e parapara me nenin 98, 99 105 dhe 116 të LPP, paneli shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues  
**Vedat Poterqoi**

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E SHËNDETËSISË**
- **OE - 2A Group SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: